

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke vlerësuar zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke konsideruar se përmbushja e misionit të këtij institucioni kërkon mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të promovimit të parimeve të barazisë, mundësive dhe shanseve të barabarta;

Duke synuar forcimin e mekanizmave institucionalë të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2019 në drejtim të:

- Shtimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese, me qëllim nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;

- Realizimit të monitorimit të aksesueshmërisë së transportit publik vendor për persona me aftësi të kufizuara;

- Kontributit të dhënë në studimin për barazinë gjinore dhe diskriminimin në organet e emëruara të pushtetit vendor, si përqasja e parë institucionale ndaj këtij fenomeni;

- Rritjes së numrit të rekomandimeve drejtuar institucioneve të administratës shtetërore, me qëllim trajtimin në baza të barabarta dhe pa diskriminim të të gjitha grupeve shoqërore;

- Identifikimit dhe propozimit të ndryshimeve dhe përmirësimeve ligjore të kuadrit rregullator në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit;

- Rritjes së bashkëpunimit me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore.

Kuvendi rekomandon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2020 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Në funksion të transparencës dhe të informimit të publikut, të plotësohen dhe të përditësohen të gjitha rubrikat në faqen zyrtare *online* të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me informacion të plotë dhe lehtësisht të aksesueshëm nga publiku i gjerë, jo më vonë sesa muaji korrik 2020.

- Të realizojë vendimmarrje të bazuara në arsyetim të plotë të vendimeve, në mënyrë që të kenë forcë më bindëse, me qëllim zbatimin direkt të tyre nga subjektet, duke synuar uljen e ankimeve ndaj këtyre vendimeve në gjykatë.

- Të garantojë pjesëmarrje aktive dhe fuqizimin institucional nëpërmjet rritjes së numrit të rasteve/çështjeve gjyqësore, duke pasqyruar domosdoshmërinë institucionale dhe zgjerimin e grupeve përfituese, në përmbushje të qëllimit dhe objektit të ligjit.

- Të rrisë komunikimin dhe bashkëpunimin me Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Policinë e Shtetit për hartimin e udhërrëfyesve për hetimin e motiveve të urrejtjes dhe mbrojtjes së viktimave të këtyre krimeve, si dhe për të krijuar një sistem të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave për veprat penale me motive urrejtjeje. Të informojë në mënyrë periodike Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

- Të publikojë statistika periodike për veprimtarinë e zyrave vendore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të informojë në mënyrë periodike Komisionin për Çështjet

Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për natyrën e problemeve të konstatuara në nivel vendor.

- Të përgatisë dhe të paraqesë në Kuvend, jo më vonë se muaji nëntor 2020, raportin e posaçëm për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus të veçantë fëmijët në arsim, fëmijët me aftësi të veçanta, fëmijët romë, egjiptianë.

- Të paraqesë një raport të veçantë për ecurinë vjetore dhe përfundimtare të Planit Kombëtar të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, si institucion përgjegjës për monitorimin e këtij plani.

- Të rrisë aktivitetet ndërgjegjësuere dhe informuese në zonat rurale, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për legjislacionin dhe rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në mbrojtje të tyre.

- Të vijojë forcimin e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit në të gjitha fushat e veprimtarisë, sidomos për të ndikuar dhe monitoruar krijimin nga institucionet përgjegjëse, përfshirë edhe policinë, të një sistemi të monitorimit të rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe të ndjekjes së tyre, me fokus të veçantë minoritetin rom, egjiptian dhe komunitetin LGBTI. Të informojë në mënyrë periodike Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ecurinë konkrete të këtij bashkëpunimi.

- Të vijojë dhe të forcojë bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile, që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore, në mbrojtje të parimeve për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe me shanse të barabarta.

- Të bashkëpunojë me median, si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit dhe si partner në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Miratuar në datën 28.5.2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi